




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



TV 21
Afërdita Kelmendi
Drejtoreshë
Prishtinë

VENDIM

**Lidhur me Rastin Nr. 2021/40 - Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për
TV 21 (Palë Përgjegjëse)**

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) është përgjegjës për zbatimin e Kreut VIII të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përmes të cilit përcaktohet sjellja e ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuale gjatë fushatës zgjedhore. Duke u bazuar në kapitullin e VIII të këtij Ligji, KPM ka nxjerrë Udhëzuesin për të ndihmuar të licencuarit që të veprojnë në pajtim me Ligjin Nr.03/L-073 për Zgjedhje e Përgjithshme, Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së.
2. Me datën 26 janar 2021 KPM i ka dërguar Palës Përgjegjëse Udhëzuesin për zbatimin e Kreut VIII të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, me qëllim që t'i ofrohen udhëzime për respektimin e dispozitave ligjore gjatë mbulimit të fushatës dhe heshtjes zgjedhore gjatë Zgjedhjeve të Përgjithshme në Republikën e Kosovës.
3. KPM, me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së Palës Përgjegjëse me Udhëzuesin për zbatimin e Kreut VIII të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, ka bërë monitorimin e këtij ofruesit të shërbimeve mediale gjatë heshtjes zgjedhore dhe në bazë të Raportit të monitorimit të datës 14 shkurt 2021, ka gjetur se Pala Përgjegjëse, konkretisht në ditën e zgjedhjeve me datën 14 shkurt 2021 ka transmetuar deklaratën e kandidatit nga PDK, z. Enver Hoxhaj, pas votimit të tij, përmbajtja e së cilës ka elemente të mesazhit politik në lidhje me zgjedhjet, veprim ky i cili bie në kundërshtim me nenin 52, paragrafi 1, të Ligjit për Zgjedhjet Nr. 03/L-073.
4. KPM me datën 14 shkurt 2021 i ka dërguar Njoftim për shkelje Palës Përgjegjëse dhe e ka njoftuar për shkeljet e bëra, si dhe ka kërkuar që të veprojnë në pajtueshmëri me Kreun e VIII të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, duke ndërmarrë veprime të menjëhershme që shkeljet e tilla mos të përsëriten.
5. Pas pranimit të Njoftimit për shkelje me datën 14 shkurt 2021 Pala Përgjegjëse është përgjigjur duke u arsyetuar që në transmetimet drejtëpërdrejta nuk arrihet që të reagohet mjaftueshëm shpejtë duke e ndalur në këtë rast deklaratën e z. Hoxhaj. Në vazhdim të

përgjigjes theksohet se nuk ka qenë e qëllimshme dhe si medium i respektuara dhe i përmbahemi rregullave të përcaktuara nga KPM.

Analiza ligjore

6. Përmes kësaj, Komisioni i Pavarur i Mediave konstaton se Pala Përgjegjëse është gjetur në shkelje të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit për Zgjedhjet Nr. 03/L-073, i cili përcakton se:

“Asnjë person ose medium nuk transmeton ose publikon çfarëdo materiali që i takon aktivitetit të fushatës gjatë periudhës që fillon njëzetekatër (24) orë para hapjes së vendotimeve deri në mbylljen zyrtare të vendotimeve.”


7. Bazuar në Raportin e monitorimit KPM ka konstatuar se Pala Përgjegjëse gjatë heshtjes zgjedhore, konkretisht në ditën e zgjedhjeve me datën 14 shkurt 2021, ka bërë shkelje të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet, ka transmetuar deklaratën e kandidatit nga PDK, z. Enver Hoxhaj, pas votimit të tij, përmbajtja e së cilës ka elemente të mesazhit politik në lidhje me zgjedhjet.
8. Prandaj, KPM duke u bazuar në faktet e lartpërmendura ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit për Zgjedhjet Nr. 03/L-073.
9. Komisioni i KPM-së si rrethanë lehësuese për Palën Përgjegjëse ka marrë parasysh përgjigjen e Palës Përgjegjëse që nuk ka qenë e qëllimshme dhe se do t'i respektojë dhe përmbahen rregullave të KPM-së.

Vendim

10. Pala Përgjegjëse sanksionohet me Vërejtje në pajtim me nenin 30, paragrafi 1, për shkelje të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

E drejta për ankesë

11. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
12. Bordi për Ankesa do t'i marrë parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.


Xhevat LATIFI
Kryetar



16.03.2021
Datë